

 NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D.
MPE "BUS STATION" J. S.

Nr. 02/704 Data 18.04.2024
No. 18.04.2024
PRISHTINË/A

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE
për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANÇAVE - MINISTARSTVO ZA FINANCIE - MINISTRY OF FINANCE
KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR
KOSOVSKI SAVET ZA FINANSIJSKO IZVEŠTAVANJE
KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL

Nr./Br./No. 165/2024 Nr.faq./Br.str./No.pg. _____
Data/Datum/Date 22.04.2024
PRISHTINË-PRISTINA-PRISHTINA



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINE
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
Prishtinë, Bill Clinton
NUI: 811318741

Deklaratë e Pajtueshmërisë

- Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2023 -

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2023 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në Pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit 06-/L-032Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Agron Sejdiu
Kryeshef Ekzekutiv

Arianit Grezda
U.D. Zyrtar Kryesor Financiar dhe i
Thesarit

PËRMBAJTJA:

| | |
|---|----|
| RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR..... | 4 |
| RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE..... | 7 |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR..... | 8 |
| PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE | 9 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET | 10 |
| PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË | 11 |
| 1. Informata të përgjithshme..... | 12 |
| 2. Bazat e përgatitjes dhe Politikat e kontabilitetit | 13 |
| 3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit..... | 13 |
| 4. Miratimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar | 16 |
| 5. Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë | 18 |
| 6. Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim..... | 19 |
| 7. Paraja dhe ekuivalentët e saj..... | 20 |
| 8. Llogaritë e arkëtueshme | 20 |
| 9. Stoqet..... | 20 |
| 10. Pasuritë tjera afatshkurta | 20 |
| 11. Prona, Pajisjet dhe Makineritë | 21 |
| 12. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera | 21 |
| 13. Detyrimet tjera afatshkurta | 21 |
| 14. Kapitali Aksionar | 21 |
| 15. Të hyrat | 22 |
| 16. Kosto e mallit të shitur..... | 22 |
| 17. Shpenzimet e personelit | 23 |
| 18. Shpenzimet administrative..... | 23 |
| 19. Shpenzimet e tjera operative..... | 24 |
| 20. Shpenzimet e tatimit në fitim..... | 25 |
| 21. Transaksionet me palët e lidhura | 25 |
| 22. Kontigjencat dhe zotimet..... | 26 |
| 23. Ngjarjet pas datës së raportimit | 26 |

RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR

Për aksionarët dhe menaxhmentin e N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A.

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A. ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2023 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç çështjeve tek baza për opinion me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitive financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2023 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion me rezervë

- Siç është shpalosur në shënimin 8 të Pasqyrave Financiare, llogaritë e arkëtueshme tregtare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 janë 105,057 Euro dhe me 31 dhjetor 2022 në vlerë 76,293 Euro. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të vërtetojmë nëse Kompania do jetë në gjendje të inkasojë vlerën e llogarive të arkëtueshme të prezantuara.
Kompania nuk ka analiza të mjaftueshme të cilat mbështesin parashikimet e menaxhmentit të bëra në relacion me balancën e provizionit të borxheve të këqija dhe të dyshimta. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare të Kompanisë më 31 dhjetor 2023. Për më tepër, Kompania nuk ka aplikuar në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në lidhje me provizionimet e llogarive të arkëtueshme. Në mungesë të analizave historike të kërkuara nga SNRF 9 dhe përcaktimin e modelit të kalkulimit të provizioneve në llogaritë e arkëtueshme ne nuk mund të vlerësojmë se sa do mund të jetë efekti në provizionim nëse do të përfillim në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në kalkulimin e provizionit.
- Siç është shpalosur në shënimin 15 të Pasqyrave Financiare, të hyrat nga aktivitetet për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 janë 1,397,926 Euro dhe me 31 dhjetor 2022 në vlerë 1,331,251 Euro, ku pjesë përbërëse e kësaj llogarie është edhe e hyra nga biletat e përjashtuara për të cilën kompania mban të drejtat e shitjes nga kompanitë e caktuara.
Sipas SNRF 15 - Të Ardhurat nga kontratat me klientët, pika B 36, njësia ekonomike njih të ardhurat në madhësinë e ndonjë tarife ose komisioni për të cilën pret të ketë të drejtë në këmbim të ndihmës ndaj palës tjetër për të ofruar për mallrat apo shërbimet e specifikuara për tu dhënë nga pala tjetër. Tarifa ose komisioni i një njësie ekonomike mund të jetë shuma neto e shumës korresponduese që njësia ekonomike mban pasi i paguan palës tjetër shumën korresponduese të marrë në këmbim të mallrave apo shërbimeve që do të ofrohen nga ajo palë. Stacioni i Autobusëve Sh.A., ka aplikuar regjistrime të gabuara kontabël, në ç' rast e ardhura është njohur në totalin e qarkullimit/bruto në vend se e ardhura të njihet vetëm për komisionin e fituar. Pasqyrimi i tillë ka shkaktuar mbivlerësim të të ardhurave të vitit 2023 dhe 2022 mbivlerësim të Kostos së Mallit të Shitur në shumën 277,545 Euro për vitin 2022 (2022: 254,377). Kjo nuk ka ndikuar në humbjen e vitit financiar në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën.

- Kompania ka njohur një rezervë të rivlerësimit prej 14,196,655 Euro (31 dhjetor 2022: 14,196,655 Euro) që është njohur në bazë të raportit të vlerësimit të kryer në vitet paraprake. Deri me datë të raportimit të pasqyrave financiare nuk është bërë rishikimi i vlerës të vlerësimit dhe as ri-vlerësim. SNRF13 dhe SNK16 kërkojnë që në rast që asetet mbahen me vlerën e drejtë të tregut të bëhet rishikim i vazhdueshëm i vlerës së drejtë të pasurive dhe po ashtu pas disa periudha të merret në konsideratë nevoja për të bërë rivlerësimin e pasurive që mbahen me vlerë të drejtë të tregut po ashtu duhet bërë dhe testimi në fund të çdo periudhe për ta parë nevojën për ramje të vlerës së asetëve. Për më tepër, në pasqyrat financiare nuk janë bërë shpalosjet e nevojshme që kërkohej sipas SNRF 13 për SNK 16, SNK 2 dhe SNK 36 për pasuritë që mbahen me vlerën e drejtë të tregut.

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përfutur e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojnë në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidanca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.

- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfthuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. L.L.C.
15 prill 2024



RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A. si dhe informacionin e shkruar ne raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10. Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues mirëpo nuk është i aprovuar nga Bordi në mungesë të emërimit të tyre, rrjedhimisht raporti llogaritet si draft dhe ne nuk japim opinion nëse ky raport është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 për pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.

Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor te kompanisë N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A. për periudhën 01 janar 2023 - 31 dhjetor 2023, me datë 30 dhjetor 2023 përmes Prokurimit Publik.
- Si pjesë e auditimit ne kemi identifikuar dhe vlerësuar rreziqet më të rëndësishme të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit. Më poshtë janë paraqitur rreziqet e rëndësishme dhe përgjigja e auditorit ndaj këtyre rreziqeve.

Vlerësimet kontabël

Kompania përdor vlerësimet kontabël në fusha të rëndësishme të pasqyrave financiare përfshirë jetëgjatësinë e aktiveve, dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe njohjen e provizioneve nga çështjet e mundshme gjyqësore. Përcaktimi i politikave lidhur me vlerësimet kontabël bëhet bazuar në përvojën historike dhe ndryshimet në faktorët ekonomik dhe të industrisë.

Përgjigja e auditorit

- o Vlerësimi i përshtatshmërisë së vlerësimeve kontabël,
 - o Vlerësimi i arsyeshmërisë së supozimeve të bëra nga menaxhmenti,
 - o Rishikimi i saldove dhe rillogaritja e shumave të përdorura në supozime dhe metoda për të arritur në vlerësimet kontabël.
- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në menyre që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shenimeve shpjeguese.
 - Ne konfirmojmë që opinionin e auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit.
 - Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në UA nr.02/2019 për pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

Lulzim Krasniqi
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. L.L.C.
15 prill 2024




N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
 Me 31 dhjetor 2023
 Të gjitha shumat në Euro

| Më 31 dhjetor | Shënim | 2023 | 2022 |
|---|--------|-------------------|-------------------|
| PASURITË | | | |
| Pasuritë afatshkurtra | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 7 | 567,706 | 404,147 |
| Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera | 8 | 105,057 | 76,293 |
| Stoqet | 9 | 720 | 720 |
| Pasuritë e tjera afatshkurtra | 10 | 95,953 | 92,352 |
| Gjithësej pasuritë afatshkurtëra | | 769,435 | 573,512 |
| Pasuritë afatgjata | | | |
| Prona, pajisjet dhe impiantet | 11 | 11,044,380 | 11,106,348 |
| Gjithsej pasuritë e tjera afatgjata | | 11,044,380 | 11,106,348 |
| Gjithsej pasuritë | | 11,813,815 | 11,679,860 |
| DETYRIMET DHE EKUITETI | | | |
| DETYRIMET | | | |
| Detyrimet afatshkurtra | | | |
| Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera | 12 | 31,295 | 30,125 |
| Detyrimet tjera afatshkurtra | 12 | 31,891 | 30,173 |
| Gjithsej detyrimet afatshkurtra | | 63,186 | 60,298 |
| EKUITETI | | | |
| Kapitali aksionar | | 25,000 | 25,000 |
| Fitimet e mbajtura | 16 | (2,471,025) | (2,602,093) |
| Rezervat e tjera | 17 | 14,196,655 | 14,196,655 |
| Gjithsej ekuiteti | | 11,750,630 | 11,619,562 |
| Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet | | 11,813,815 | 11,679,860 |

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe nuk janë miratuar Bordi mirëpo janë të paraqitura nga menaxhmenti i N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A. dhe janë nënshkruar më 26 shkurt 2024 në emër të:


Agron Sejdiu
 Kryeshef Ekzekutiv


Arianit Grezda
 U.D. ZKFTH


Emin Sylejmani
 Kontabilist i Çertifikuar

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

| Për vitin që përfundon më 31 dhjetor | | 2023 | 2022 |
|---|----------------|------------------|------------------|
| | <i>Shenimi</i> | | |
| Të hyrat | 14 | 1,397,926 | 1,331,251 |
| Kostoja e shitjes | 15 | (277,545) | (254,377) |
| Fitimi/(humbja)bruto | | 1,120,381 | 1,076,874 |
| Të ardhurat e tjera | | - | - |
| Shpenzimet e shpërndarjes të pagave | 15 | (796,669) | (809,422) |
| Shpenzimet administrative | 15 | (21,013) | (19,041) |
| Shpenzimet e tjera operative | 15 | (71,383) | (39,338) |
| Shpenzimet e zhvlerësimit | 15 | (79,214) | (77,142) |
| Fitimi/(humbja) operativ | 16 | 152,102 | 131,932 |
| Shpenzimet financiare | | - | - |
| Të ardhurat financiare tjera | | - | - |
| Fitimi para tatimit | | 152,102 | 131,932 |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | 16 | (21,035) | (8,984) |
| Fitimi/(humbja)i/e vitit | | 131,067 | 122,948 |

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat Euro

| | Kapitali aksionar | Fitimet e mbajtura | Rezervat e tjera | Gjithsej |
|---------------------------------------|------------------------------|-------------------------------|-----------------------------|-------------------|
| Gjendja më 31 dhjetor 2021 | 25,000 | (2,725,041) | 14,196,655 | 11,496,613 |
| Fitimi/humbja i/e vitit | - | 122,948 | - | 122,948 |
| Ndarja e rezervave | - | - | - | - |
| Gjendja më 31 dhjetor 2022 | 25,000 | (2,602,093) | 14,196,655 | 11,619,561 |
| Fitimi/humbja i/e vitit | | 131,067 | | 131,067 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2023 | 25,000 | (2,471,025) | 14,196,655 | 11,750,630 |

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumat Euro

| Për vitin që përfundon më 31 dhjetor | 2023 | 2022 |
|--|-----------------|----------------|
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative | | |
| Fitimi/(humbja) i/e vitit | 152,102 | 131,932 |
| Rregollimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave | | |
| Zhvierësimi i pronës paisjeve dhe impianteve | 79,214 | 77,142 |
| Ndryshimi i vlerës së pronës investuese | - | - |
| Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues | 231,316 | 209,074 |
| Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative | | |
| (Rritja) / Zvoglimi në llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjera | (28,764) | (10,210) |
| (Rritja) / Zvoglimi në stoqe | - | 448 |
| (Rritja) / zvoglimi në pasuritë e tjera | (3,600) | 16,413 |
| Rritja / zvoglimi në llogartë e pagueshme tregtare dhe të tjera | 1,170 | 11,948 |
| Rritja / (zvoglimi) në detyrimet e tjera | 1,718 | 3,164 |
| Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative | (29,476) | 21,763 |
| Tatimi në fitim i paguar | (21,035) | (8,984) |
| Interësi i paguar | - | - |
| Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative | 180,805 | 221,853 |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese | | |
| Pagesat për blerjen e pronës,paisjeve dhe impianteve | (17,246) | (5,599) |
| Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese | (17,246) | (5,599) |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese | | |
| Deponimet e kapitalit shtesë - Rezervat tjera | - | - |
| Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese | - | - |
| Rritja/(zvoglimi) neto i parasë dhe i ekuivalentëve të parasë | 163,559 | 216,254 |
| Paraja dhe ekuivalentët e parsë në fillim të vitit | 404,147 | 187,893 |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit | 567,706 | 404,147 |

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

1. Informata të përgjithshme

Ndërmarrja Shoqërore Stacioni i Autobusëve, është themeluar me vendimi te Kuvendit Komunal te Prishtinës me aktin nr. 110-94/77-01, te datës 15 Nëntor 1977. Ndërsa, kjo ndërmarrje punën e ka filluar ne vitin 1983.

Pas përfundimit te luftës se vitit 1999, kjo ndërmarrje është regjistruar ne baze te rregullores se UNMIK-ut 2000/6 mbi Shoqëritë Tregtare me numër te biznesit 80060165 datë. 14.06.2000 dhe është administruar nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) dhe më pastaj i transformuar Agjencioni Kosovari i Privatizimit (AKP).

Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr. 04/L – 111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, Stacioni i autobusëve SH.A. në Prishtinë është paraparë në Listën 2, ku janë caktuar Ndërmarrjet publike lokale në nivel të Kosovës. Mbi bazën e këtyre ligjeve, Kuvendi Komunal i Prishtinës është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i te gjitha aksioneve te ndërmarrjes.

Duke u bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, Stacioni i autobusëve, veprimtarinë e tij do ta ushtrojë me emërtimin: Ndërmarrja publike lokale "Stacioni i autobusëve", SH.A, Prishtinë i regjistruar me numër te ri te biznesit (NRB) 71224851 me datë 21.01.2015 dhe me numër fiskal pranë ATK-se 600118245. Emërtimin i shkurtër i ndërmarrjes së cekur në paragrafin 2 të këtij neni është: NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Prishtinë.

Kuvendi Komunal i Prishtinës ne emër te pronarit te vetëm te aksioneve e ushtron kompetencën dhe përgjegjësinë në bazë te Ligjit, Statutit dhe akteve tjera nënligjore.

Ndërmarrja është e licencuar nga Ministria e transportit dhe Postë Telekomunikacionit për ushtrimin e veprimtarisë së sajë me Licencë me nr.002/18 të datës 02.05.2018. Licenca lëshohet për 5 (pesë) vite e cila ka karakterin e plasimit në kategorizimin e stacioneve e cila sipas licencës në fjale i ka plotësuar kushtet për kategorinë "A" nga katër kategoritë e parapara me Udhëzimin Administrativ (kat. "A", "B", "C" dhe "D" nga ma kualitative në atë më të dobët).Ndërmarrja posedon sipërfaqe e objekte të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarisë si vijon :

- Sipërfaqe 7 ha e 62 ari e 29m², (Fleta Poseduese ZK Prishtinë nr. 8296 me numërprotokolli 2262/02 dt. 10.07.2002.

- Ndërtesa e drejtorisë afërsisht 5,228 m²,

- Servisi i larjes së autobusëve me dy kanale afër 568 m² katrore (e dhënë me qira),

- Perona 21 me nr. rendor prej 1 deri 21 me mbishkrim të linjës. Ndërmarrja posedon edhe objekte përcjellëse si që janë: informata, dispiqeringu, biletarinë, shenjat e komunikacionit vertikal dhe horizontal, stazat dhe parkingu.

Aktivitetet janë:

| Kodi | Përshkrimi | Tipi |
|------|---|-----------|
| 5229 | Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit | Primarë |
| 7990 | Shërbimet e tjera të rezervimit dhe aktivitetet e lidhura me to | Sekondarë |
| 8299 | Aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t. | Tjera |
| 5221 | Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor | Tjera |
| 7911 | Aktivitetet e agjencive të udhëtimit | Tjera |

Gjatë vitit 2022 Kompania kishte mesatarisht 66 të punësuar (2021: 66 punëtorë).

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

2. Bazat e përgatitjes dhe Politikat e kontabilitetit

2.1 Përputhshmëria dhe baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Interpretimet (ndryshe IFRS) të botuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) siç janë adaptuar nga Unioni Evropian ("IFRS të adaptuara"), UDHËZIM ADMINISTRATIV MF-NR. 07/2019 PËR STRUKTURËN, PËRMBAJTJEN DHE DORËZIMIN E RAPORTIMEVE FINANCIARE VJETORE . Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat matëse të specifikuar në procedurë për çdo lloj të asetëve, të detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë plotësisht të përshkruara në politikat e kontabilitetit më poshtë

2.2 Parimi i vazhdimsisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdimsisë.

3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

3.1 Prona, impiantet dhe pajisjet

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve që ekzistojnë me 1 janar 2020 janë bartur sipas kostonë të tyre historike, minus zhvlerësimi i akumuluar pasues Kostonë paraqet shpenzimin që i atribuohet drejtpërdrejtë përvetësimi (blerjes) të zërave. Kostot pasuese janë përfshirë në vlerë bartëse të mjeteve apo është njohur si mjet i veçantë, në mënyrë të duhur, vetëm atëherë kur përfitimet ekonomike të mundshme lidhur me këtë mund të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Gjatë vitit 2018 është bërë edhe Vlerësimi i pronës ku zhvlerësimi i objekteve përfshinë vlerën e cila buron nga vlera më e ulët se vlera kontabël.

Zhvlerësimi i pasurive është bërë me metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre ose shumat e rivlerësuar të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar, siç vijon:

| | |
|--|-----|
| Ndërtesat | 5% |
| Pajisjet prodhuese dhe makineria, | 10% |
| Kompjuterët, Pajisjet e zyrës, veturat | 20% |

Vlerat e mbetura të pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar, dhe rregulluar nëse është e nevojshme, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera bartëse e një pasurie është e shënuar menjëherë në vlerën e saj të rikuperueshme nëse vlera bartëse e pasurisë është më e madhe se sa është parashikuar vlera e rikuperueshme.

Humbjet ose fitimi janë përcaktuar nga rrjedha e krahasimit me vlerën bartëse. Këto janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave.

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

3.2 Dëmtimet e aseteve jo-financiare

Pasuritë të cilat kanë jetë përdorimi të padefinuar nuk i janë nënshtruar zhvlerësimit dhe testohen çdo vit përdëmtimin në vlerë. Pasuritë të cilat i nënshtrohen zhvlerësimit janë rishikuar për dëmet kurdo që ndodhin ose në rrethanat të cilat e shtyjnë që vlera bartëse nuk mund të rikuperohet. Humbjet nga dëmet janë njohur për vlerën të cilën e kalon vlerën e rikuperueshme të vlerës bartëse të pasurisë. Vlera e rikuperimit është vlera më e madhe në mes të vlerës së një pasurie në përdorim dhe vlerës fer të saj minus kosto e shitjes. Për qëllime të vlerësimit të dëmeve, pasuritë që nuk mund të testohen në mënyrë individuale janë të grupuara në nivelin më të ultë të pasurive që gjenerojnë para nga përdorimi i vazhdueshëm i tyre e që janë të pavarura nga pasuritë tjera ose grupe të pasurive. Pasuritë jo-financiare të cilat janë dëmtuar janë rishikuar në mundësi pezullimi të dëmeve në secilën datë raportimi.

3.3 Asetet Financiare

Asetet Financiare klasifikohen në kategoritë e specifikuar vijuese: mjetet financiare në vlerën reale përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe të arkëtueshmet, mallrat e gatshmet për shitje. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i mjeteve financiare që janë përvetësuar. Menaxhmenti e përcakton klasifikimin e mjeteve financiare në njohjen fillestare. Deri në datën e bilancit të gjendjes Kompania nuk ka asete të klasifikuar në kategoritë e vlerës fer përmes Fitimit apo Humbjes aseteve të gatshme për shitje. Blerjet dhe shitjet e aseteve financiare njihen në datën e tregtimit-data kur Kompania zoton blerjen apo shitjen.

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë asetet financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktuara që nuk janë kuotuar në treg aktiv. Janë të përfshira në asetet qarkulluese, përveç atyre që maturohen pas 12 muaj pas datës së bilancit të gjendjes. Këto janë klasifikuar si pasuri jo-qarkullues. Kreditë dhe të arkëtueshmet e Kompanisë përbëhen prej „të arkëtushmeve tregtare tjera, parasë dhe ekuivalenteve të parasë në bilancin e gjendjes.

3.4 Të arkëtueshmet tregtare dhe tjera

Të arkëtueshmet tregtare njihen në fillim në vlerën e tyre reale dhe më pas të matura më koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit, minus provizionin për dëme. Provizionin për dëmet e të arkëtueshmeve tregtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme që Kompania nuk do të jetë në gjendje t'i mbledh të gjitha shumat sipas kushteve origjinale. Vështirësitë e mëdha të debitorit, me gjasë që debitori do të bankrotoj apo do të riorganizohet financiarisht, mos pagesa apo gabimi në pagesa (që vonohen më shumë se 30 ditë) konsiderohen si indikator që të arkëtueshmet tregtare janë dëmtuar. Shuma e provizionit është diferenca në mes vlerës bartëse të aseteve dhe vlera prezentë e vlerësuar e rrjedhjes së parasë në të ardhmen, e zbritur në normën origjinale efektive të interesit. Asetet me maturi afatshkurta nuk janë zbritur. Vlera bartëse e mjeteve zvogëlohet për mes përdorimit të një kontoje për lejime, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave në „koston e shitjeve dhe të marketingut“. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pambledhshme, shlyhet kundër kontos për lejimet e të arkëtushmeve tregtare. Paraprakisht kthimi i shumave, të shlyera më parë kreditohen kundër „koston e shitjeve dhe të marketingut në pasqyrën e të ardhurave.

3.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas koston. Për qëllime të pasqyrës se rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

3.6 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përbehet nga vlera reale e monetare e evidentuar dhe kontribuar nga aksionaret e Kompanisë. Në bazë të statutit të ndërmarrjes me rastin e themelimit të NPL "Stacioni i autobusëve" Sh.A, Prishtinë ka të paraqitura aksione në vlerë prej 25,000.00€.

3.7 Beneficionet e të punësuarve

Kompania kontribuon për punëtorët e saj në planet pas pensionimit si janë të përshkruara nga legjislacioni për kontributet pensionale. Kontributet, bazuar në paga, bëhen në organizatën kombëtare përgjegjëse për pagesat e pensioneve. Nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane dhe këto skema konsiderohen si plan i caktuar i kontributeve. Kompania gjatë pensionimit i ka dhënë nga 3 paga përcjellese për punëtorëve të pensionuar.

3.8 Të pagueshmet tjera dhe tregtare

Të pagueshmet tjera dhe tregtare njihen në vlerën reale dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

3.9 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të hyrat njihen atëherë kur ekziston dëshmia bindëse, që zakonisht është në formë të marrëveshjeve për shitje, pasi që rreziqet dhe përfitimet domethënëse të pronësisë janë transferuar tek blerësi dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme. Të hyrat nga shërbimet njihen në pasqyrën e të ardhurave në proporcion me fazën e përfundimit (kompletimit) të transaksionit në datën e raportimit. Faza e kompletimit vlerësohet duke iu referuar ekzaminimit të punës së kryer. Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në kohën e pranimit të shërbimit ose në datën e origjinës.

3.10 Provizionet

Provizioni njihet kur Kompania ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe kompania ka një obligim aktual ose të parashikuar që mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme dhe është e mundshme të kërkoet rrjedhë dalëse e përfitimeve ekonomike për të paguar obligimin. Provizionet janë rishikuar në çdo datë të bilancit të gjendjes dhe rregulluar të reflektuar parashikimet me të mira të tanishme. Kur ndikimi i vlerës në kohë të parasë është material, shuma e provizionit është vlera e tanishme e shpenzimeve të pritura që do kërkoen të vendoset obligimi.

3.11 Zotimet dhe kontigjencat

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve është e largët. Si detyrim kontigjent do të njihen në shpalosje të gjitha lëndët gjyqësore apo lëndët në inspektoriat të punës të marra nga departamenti juridik e që në të ardhmen do të kenë efekte financiare. Pasuria kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur ardhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjeve kontigjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë at detyrim të shfaqur në datën e bilancit të gjendjes dhe parashikimi i arsyeshëm i shumës së rezultuar të humbjes që mund të bëhet.

**N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

4. Miratimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar

(i) Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Në vitin aktual, Kompania ka aplikuar një sërë ndryshimesh në SNRF-ve të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë në fuqi për periudhën raportuese që fillon më ose pas 1 janarit 2023. Miratimi i tyre nuk ka pasur ndonjë material ndikim në dhënien e informacioneve shpjeguese ose në shumat e raportuara në këto pasqyra financiare.

- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimit"** botuar nga BSNK më 18 maj 2017. Standardi i ri kërkon që detyrimet e sigurimit të maten me një vlerë aktuale të përmbushjes dhe ofron një qasje më uniforme matje dhe paraqitje për të gjitha kontratat e sigurimit. Këto kërkesa janë krijuar për të arritur qëllimin e një kontabiliteti konsistent dhe të bazuar në parime për kontratat e sigurimit. SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" dhe interpretimet përkatëse kur zbatohet. Ndryshimet në SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" të lëshuara nga BSNK më 25 qershor 2020 shtyjnë datën e zbatimit fillestar të SNRF 17 me dy vjet, për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2023. Për më tepër, ndryshimet e lëshuara më 25 qershor 2020 paraqesin thjeshtime dhe sqarime të disa kërkesave në Standard dhe ofrojnë lehtësira shtesë kur zbatohet SNRF 17 për herë të parë.
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" - Dhënia e informacioneve shpjeguese** të politikave kontabël të publikuara nga BSNK më 12 shkurt 2021. Ndryshimet kërkojnë që kompanitë të japin informacion shpjegues për politikën e tyre kontabël materiale në vend të politikave të tyre të rëndësishme kontabël dhe të ofrojnë udhëzime dhe shembuj për të ndihmuar përgatitësit të vendosin se cilat politikë kontabël të shpalosen në pasqyrat e tyre financiare.
- **Ndryshimet në SNK 8 "Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet" - Përkufizimi i vlerësimeve kontabël** të publikuar nga BSNK më 12 shkurt 2021. Ndryshimet fokusohen në vlerësimet kontabël dhe ofrojnë udhëzime se si të bëhet dallimi midis politikave kontabël dhe vlerësimeve kontabël.
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat" - Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm i lëshuar nga BSNK më 6 maj 2021.** Sipas ndryshimeve, përjashtimi nga njohja fillestare nuk zbatohet për transaksionet në të cilat, edhe differencat e përkoshme të zbritshme dhe të tatueshme, lindin në njohjen fillestare që rezultojnë në njohjen e barabartë të pasurive dhe detyrimeve tatimore të shtyra.
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat" - Reforma Ndërkombëtare e Tatimeve - Rregullat Model Shtylla e Dytë** të lëshuara nga BSNK më 23 maj 2023. Ndryshimet prezantuan një përjashtim të përkohshëm nga kontabilizimi për tatimet e shtyra që rrjedhin nga juridiksionet që zbatojnë rregullat globale tatimore dhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese rreth ekspozimit të kompanisë ndaj taksave mbi të ardhurat që rrjedhin nga reforma, veçanërisht përpara se legjislati që zbaton rregullat të jetë në fuqi.

Miratimi i këtyre standardeve të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi nuk kanë çuar në ndryshime materiale në pasqyrat financiare të kompanisë.

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

Miratimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar (vazhdim)

(ii) Standardet dhe ndryshimet në standardet ekzistuese akoma jo-efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese u nxorën nga BSNK mirëpo nuk janë akoma efektive:

- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë" - Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe rimarrja me qira** të lëshuar nga BSNK më 22 shtator 2022. Ndryshimet në SNRF 16 kërkojnë që një shitës-qiramarrës të masë më pas detyrimet e qirasë që rrjedhin nga një rimarrje me qira në një mënyrë që ai të mos njohë asnjë shumë të fitimit ose humbjes që lidhet me të drejtën e përdorimit që ruan. Kërkesat e reja nuk e pengojnë një shitës-qiramarrës që të njohë në fitim ose humbje çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë.
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" - Klasifikimi i Detyrimeve afatshkurtëra ose afatgjata** të lëshuara nga BSNK më 23 janar 2020 dhe **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" - Detyrimet afatgjata të kushtëzuara** të lëshuara nga BSNK më 31 tetor 2022. Ndryshimet e lëshuara në janar 2020 ofrojnë një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në fuqi në datën e raportimit. Ndryshimet e nxjerra në tetor 2022 sqarojnë se si kushtet të cilat një kompani duhet të përmbushë brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës raportuese ndikojnë në klasifikimin e një detyrimi dhe caktojnë datën efektive për të dy ndryshimet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024.
- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Rrjedhës së Parasë" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese" - Marrëveshjet financiare të furnizuesve** të lëshuara nga BSNK më 25 maj 2023. Ndryshimet shtojnë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese dhe "tabela sqaruese" brenda kërkesave ekzistuese për dhënie informacionesh shpjeguese cilësore dhe sasiore në lidhje me marrëveshjet financiare të furnizuesit.
- **Ndryshimet në SNK 21 "Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor" - Mungesa e këmbyeshmërisë** të lëshuar nga BSNK më 15 gusht 2023. Ndryshimet përmbajnë udhëzime për të specifikuar kur një monedhë është e këmbyeshme dhe si të përcaktohet kursi i këmbimit kur nuk është në dispozicion.
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta" - Shitja ose kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët** të lëshuar nga BSNK më 11 shtator 2014. Ndryshimet trajtojnë një konflikt midis kërkesave të SNK 28 dhe SNRF 10 dhe sqarojnë se në një transaksion që përfshin një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, shkalla e njohjes së fitimit ose humbjes varet nëse pasuritë e shitura ose të kontribuara përbëjnë një biznes.

Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së hyrjes në fuqi. Kompania parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar.

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

5. Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit, të cilat janë të përshkruara në Shënimin 3, nga menaxhmenti kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e bartura të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të qarta nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorët tjerë të cilët konsiderohen të jenë relevantë.

a) Faktorët e riskut financiar

a) Aktivitetet e kompanisë e vënë atë në një shumëllojshmëri të riskut financiar, duke përfshirë riskun e tregut dhe riskun e likuiditetit. Menaxhimi i riskut të kompanisë përqendrohet në pa-parashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon që të minimizon efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të kompanisë.

b) Risku i tregut

Risku i tregut është risk që ndryshon në cmimet e tregut, mosarkëtimi i llogarive të arkëtueshme që do të ndikojë në të ardhurat e kompanisë. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhij dhe të kontrolloj ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda paramentrave të pranueshëm, derisa optimizon kthimin.

c) Risku i monedhës

Në përgjithësi, kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të monedhës pasi që të gjitha blerjet janë në valutën Euro.

d) Risku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borgjeve dhe detyrimeve financiare, si dhe hyrje e parave të parashikuara dhe dajet e parasë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditet miratohen në kohë të ndryshme, në baza ditore dhe javore, si dhe në baze të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepriçë apo mungesë. Kjo analize tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vrotim.

Më 31 dhjetor 2023 detyrimet e kompanisë kishin maturitet të kontraktuar të përmbledhur si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2023 | Më 31 dhjetor 2022 |
|--|-----------------------|-----------------------|
| Pasuritë | | |
| Paratë në bank dhe arkë | 567,706 | 404,147 |
| Llogarite e arkëtueshme | 105,057 | 76,293 |
| Parapagimet dhe kërkesat tjera | 720 | 101,336 |
| Stoqet | 95,953 | 720 |
| Total Pasuritë Afatshkurta | 769,435 | 582,496 |
| Detyrimet | | |
| Llogarite e pagueshme | 31,295 | 30,125 |
| Tatimet e pagueshme | 31,891 | 30,174 |
| Gjithësej Detyrimet Afatshkurta | 63,186 | 60,300 |
| Hapsira e likuiditetit | 706,249 | 522,196 |

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumat në Euro

6. Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një rrezik domethënës për të shkaktuar korrigjime materiale në vlerën e bartur të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë:

Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare:

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme. Duke u bazuar në këtë, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

Vlerësimi i rasteve ligjore:

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën një vlerësim për shumat që nevojiten për shlyerjen e rasteve ligjore sipas udhëzimit të këshilltarit ligjor të Kompanisë. Në bazë të këtij vlerësimi, Kompania në përputhje me këtë regjistron provizionin, nëse ka, apo shpalos detyrimin kontingjent. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

Vlerësimi për çështjet ambientale, çaktivizimin dhe çështjet tjera të ndërlidhura, aktualisht nuk ka asnjë kërkesë detyruese ligjore për mjedisin, çaktivizimin dhe dispozitat tjera të lidhura në Kosovë

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

7. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja e gatshme në fund të periudhës përbëhet nga pjesa e mbetur e parave që zotëron subjekti më 31 dhjetor 2023 në llogaritë bankare me te cilat bashkëpunon në BKT, NLB Bank Prishtina . Subjekti aplikon sistemin e hyrjeve të dyfishta në lidhje me të gjitha transaksionet ekonomike që ndodhin në periudhë. Subjekti bënë regjistrimin e transaksioneve bankare dhe bënë konsolidimet bankare me paranë e gatshme në fund të vitit.

Paraja ne banke dhe arke me date 31 dhjetor 2023 është :

| | Më 31 dhjetor 2023 | Më 31 dhjetor 2022 |
|----------------|---------------------------|---------------------------|
| Paraja në bank | 559,238 | 398,555 |
| Paraja në dorë | 8,468 | 5,592 |
| Total | 567,706 | 404,147 |

8. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 përbëhen si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2023 | Më 31 dhjetor 2022 |
|----------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Llogaritë e arkëtueshme tregtare | 105,057 | 76,293 |
| Total: | 105,057 | 76,293 |

9. Stoqet

Vlerat e stoqeve janë vlera që ndahen nga shpenzimet, prej aktivizimit të depoz, pra nuk janë stoqe të gatshme për rishitje , por ndarje e shpenzimit prej regjistrimit në kontabilitet e deri në përdorimin final të tyre. Në stoqe vlen të theksohet janë edhe biletat manuale që përdoren në rast të mosfunksionimit të programit të shitjes.

| | Më 31 dhjetor 2023 | Më 31 dhjetor 2022 |
|---------------|---------------------------|---------------------------|
| Stoqet | 720 | 1,168 |
| Total: | 720 | 1,168 |

10. Pasuritë tjera afatshkurta

| | Më 31 dhjetor 2023 | Më 31 dhjetor 2022 |
|---|---------------------------|---------------------------|
| Parapagime | 3,722 | 2,867 |
| Paradhënje e tatimit në fitim | 19,827 | 17,082 |
| Tatimi i mbajtur në burim nga qiraxhinjët | 72,403 | 72,403 |
| Total: | 95,953 | 92,352 |

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

11. Prona, Pajisjet dhe Makineritë

| | Toka | Ndërtesa | Makina dhe Pajisje | Total |
|-------------------------------|-------------------|------------------|---------------------------|-------------------|
| <i>Kosto</i> | | | | |
| Më 31 dhjetor 2021 | 10,090,000 | 1,181,736 | 151,359 | 11,423,094 |
| Shtesat | | | 5,599 | 5,599 |
| Më 31 dhjetor 2022 | 10,090,000 | 1,181,736 | 156,958 | 11,428,693 |
| Shtesat | | | 17,246 | 17,246 |
| Më 31 dhjetor 2023 | 10,090,000 | 1,181,736 | 156,958 | 11,445,939 |
| <i>Amortizimi i akumuluar</i> | | | | |
| Më 31 dhjetor 2021 | - | (177,183) | (68,021) | (245,204) |
| Amortizimi për vitin | - | (59,087) | (18,055) | (77,142) |
| Më 31 dhjetor 2022 | - | (236,269) | (86,076) | (322,345) |
| Amortizimi për vitin | - | (59,913) | (19,301) | (79,214) |
| Më 31 dhjetor 2023 | - | (59,913) | (105,377) | (401,559) |
| <i>Vlera kontabël neto</i> | | | | |
| Më 31 dhjetor 2022 | 10,090,000 | 945,467 | 70,882 | 11,106,348 |
| Më 31 dhjetor 2023 | 10,090,000 | 1,121,823 | 51,581 | 11,044,380 |

12. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2023 | Më 31 dhjetor 2022 |
|--------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Llogaritë e pagueshme tregtare | 31,295 | 30,125 |
| Total: | 31,295 | 30,125 |

13. Detyrimet tjera afatshkurta

| | Më 31 dhjetor 2023 | Më 31 dhjetor 2022 |
|-------------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Sigurime shoqerore dhe shendetesore | 11,231 | 9,483 |
| Tatim mbi te ardhurat personale | 3,321 | 3,950 |
| Shteti-tvsh e pagueshme | 14,880 | 14,271 |
| Tvsh e zbritshme | - | 10 |
| Tjera | 2,459 | 2,459 |
| Total: | 31,891 | 30,173 |

14. Kapitali Aksionar

Me 31 dhjetor 2023, kapitali aksionar i regjistruar është 25,000 EUR sipas ARBK i përbërë nga 25,000 aksione me vlerë nominale prej 1 EUR për aksion. Komuna e Prishtinës ka në zotërim Kompaninë. Aksionet janë të zakonshme dhe nuk ka kufizime apo preferenca të bashkangjitura.

| | Më 31 dhjetor 2023 | Më 31 dhjetor 2022 |
|---------------------|---------------------------|---------------------------|
| Aksionari | Kapitali në % | Kapitali në % |
| Komuna e Prishtinës | 100% | 100% |
| Total në % | 100% | 100% |

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

15. Të hyrat

Të hyrat nga shitja më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

| | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 |
|---------------------------------|--|--|
| Te hyrat nga qeraja | 176,953 | 176,981 |
| Te hyrat nga sherbimi biletave | 12,172 | 11,626 |
| Biletave te perjashtuara | 313,492 | 286,534 |
| Te hyrat nga parkingi | 309,369 | 267,840 |
| Te hyrat nga peronizimi | 580,788 | 568,361 |
| Te hyra nga qeraja mujore rryma | | |
| Reklama vjetore | 2,881 | 3,898 |
| Te hyrat e jashtzakonshme | 240 | 15,558 |
| Te hyrat nga garderoba | 2,032 | 455 |
| Të hyrat nga Aktivitetit | 1,397,926 | 1,331,251 |
| Te hyrat nga subvencionet | - | - |
| Total: | 1,397,926 | 1,331,251 |

16. Kosto e mallit të shitur

| | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 |
|--------------------------|--|--|
| Biletave të përjashtuara | 277,545 | 254,377 |
| Total: | 277,545 | 254,377 |

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

17. Shpenzimet e personelit

Përfitimet e punëtorëve për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

| | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 |
|--------------------------------------|--|--|
| Pagat dhe shperblimet e personelit | 758,854 | 770,950 |
| Sigurimet shoqerore dhe shendetesore | 37,815 | 38,472 |
| Total: | 796,669 | 809,422 |

18. Shpenzimet administrative

Shpenzimet tjera administrative për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

| | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 |
|--|--|--|
| Shpenzimet e materialit per zyre | 1,374 | 1,743 |
| Shpenzimet për udhetime bileta për punetore | - | 2,280 |
| Shpenzimet e reprezentacionit te KE-se | 7,451 | 2,847 |
| Shpenzimet e derivateve te vetures | 1,757 | 1,340 |
| Shpenzimet per uje te pijes per punonjesit e ndermarrjes | 831 | 766 |
| Shpenzimet e telefonit mobil | 1,706.89 | 1,843 |
| Shpenzimet e telefonit fiks | 912.04 | 768 |
| Shpenzime Interneti | 106.78 | 58 |
| Shpenzimet e sanitarise | 805 | 894 |
| Shpenzimet e fotokopjes - Printerit | 1,055.07 | 872 |
| Shpenzim per dezinfektim te hapsirave SAP | 620 | |
| Shpenzime te mirembajtes se programit - Bilanc | 1,241 | |
| Shpenzim per domain hostim te web-faqes, email - mirembajtja vjetore | 339 | |
| Shpenzime per vendime gjyqesore | 713 | |
| Shpenzime tjera të jashtëzakonshme | - | 5,000 |
| Shpenzime tjera. | 2102.51 | 630 |
| Total: | 21,013 | 19,041 |

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

19. Shpenzimet e tjera operative

| | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 |
|--|--|--|
| Shpenzimet e rrymes | 12,866 | 11,453 |
| Shpenzimet e ujit | 5,934 | 5,616 |
| Shpenzimet e mirembajtjes se objektit | 295 | 1,512 |
| Shpenzimet e mbeturinave | 11,896 | 2,618 |
| Shpenzimet e mirembajtjes se energjise | 12 | 12 |
| Shpenzimet bankare | 895 | 666 |
| Shpenzimet e mirembajtjes se veturave zyrtare | 1,381 | 530 |
| Shpenzimet e mirembajtjes se peronave | 39 | 98 |
| Shpenzimet e programit te sistemit te digjitalizimit | 11,282 | 6,926 |
| Shpenzimet e mirembjtjes se aparatit kunder zjarrit | 164 | 83 |
| Shpenzimet per license ne MIT | 3,100 | |
| Shpenzimet e mirembajtjes se energjise elektrike | 378 | |
| Shpenzimet per taksa komunale | 6,481 | 2,076 |
| Shpenz.e sherb.te mirmbajtj | 1,703 | |
| Shpenz.matjes se rezist-tok | 621 | |
| Shpenz.Ekskurzionit punetor | 2,848 | |
| Shpenzimet per gjoba | 2,683 | |
| Instituti i mjeksise se punes | 4,290 | |
| Shpenzime tjera | 4,515 | 7,748 |
| Total: | 71,383 | 39,338 |

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

20. Shpenzimet e tatimit në fitim

Sipas ligjit nr. 03/L-162 "Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave", në fuqi nga 1 janar 2010, norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave ka qenë 10%.

| Për vitin që përfundon me 31 dhjetor | 2023 | 2022 |
|--|----------------|-----------------|
| Fitimi kontabël për vitin | 152,102 | 131,932 |
| Shpenzimet e papranuara | 58,245 | - |
| Humbjet e bartura | - | (42,094) |
| Fitimi i tatueshëm | 210,347 | 89,838 |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | 21,035 | 8,984 |
| Këstet e paguara | 9,882 | 3,735 |
| Tatimi i mbajtur në Interes, të Drejtat Pronësore dhe Qira nga paguesit rezident | 13,095 | 15,614 |
| Parapagimi i tatimit në fitim | (1,942) | (10,365) |

21. Transaksionet me palët e lidhura

Një person ose një palë e afërt e familjes së atij personi është e lidhur me Kompaninë raportuese nëse ai person:

- ka kontroll ose kontroll të përbashkët mbi Kompaninë raportuese; ka kontroll ose kontroll të përbashkët të Kompanisë raportuese;
- ka ndikim të rëndësishme mbi Kompaninë raportuese; ose
- është anëtar i menaxhmentit kyq të Kompaninë raportuese ose mëmë të Kompanisë raportuese.

Një entitet është i lidhur me Kompaninë raportuese nëse ndonjë prej kushteve të mëposhtme aplikohet:

- Entiteti dhe Kompania raportuese janë anëtare të të njëjtit grup (që do të thotë që çdo entitet mëmë, filialë dhe degë filiale është e lidhur me të tjerët).
- Entiteti është shoqëri ose ndërmarrje e përbashkët e entitetit tjetër (ose një shoqëri apo ndërmarrje e përbashkët e një anëtari të grupit në të cilën shoqëria tjetër është anëtar).
- Të dyja entitetet janë ndërmarrje të përbashkëta të së njëjtës palë të tretë.
- Njëri entitet është ndërmarrje e përbashkët e e palës së tretë dhe entiteti tjetër është shoqëri e entitetit të tretë.
- Entiteti është një plan përfitimi pas punësimit për përfitimet e punëtorëve të entitetit raportues ose një entiteti të lidhur me entitetin raportues. Nëse entiteti raportues është një plan I tillë, punëtorët sponsorues janë gjithashtu të lidhur me entitetin raportues.
- Entiteti është i kontrolluar ose ka kontroll të përbashkët nga një person i afërt ose një anëtar i afërt i familjes së atij personi.
- Një person i lidhur ka ndikim të rëndësishëm mbi entitetin ose është anëtar i menaxhmentit kyq të entitetit (ose Kompanisë mëmë të entitetit).

Një transaksion me një palë të lidhur është një transfer i resurseve, shërbimeve ose obligimeve mes Kompanisë raportuese dhe një pale të lidhur, pavarësisht nëse çmimi është ngarkuar.

Gjatë vitit Kompania kishte transaksione me palët e ndërlidhura si në vijim:

| Pagat për Bordin dhe Kryeshefin dh Aksionaret: | 2023 | 2022 |
|---|---------------|---------------|
| Pagat për Bordin dhe Komitetin e Auditimit | 6,038 | 25,938 |
| Paga vjetore e Kryeshefit Ekzekutiv | 13,576 | 16,967 |
| Paga Vjetore e Aksionareve | 10,730 | 9,745 |
| TOTAL | 30,344 | 52,650 |

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

22. Kontigjencat dhe zotimet

Detyrimet ndaj tatimeve

Pasqyrat financiare dhe regjistrimet kontabël të kompanisë nuk janë audituar nga autoritetet e taksave për periudhën 01 janar 2023 – 31 dhjetor 2023 kështu që obligimet tatimore të Ndërmarrjes nuk mund të konsiderohen si të përfunduara.

Çështjet gjyqësore

Me 31 dhjetor 2023, Kompania ka pasur këto çështje gjyqësore të hapur me vlerë materiale për pasqyrat financiare:

23. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje tjera domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.